

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti ekonomik
Titulli i lëndës:	Ekonomiksi i Sektorit Publik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë; Semestri 3
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. But Dedaj
Detajet kontaktuese:	But.dedaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë do të analizojmë sukseset, dështimet dhe kompromiset e rëndësishme në ndërhyrjet e qeverisë në një sërë fushash si arsimi, kujdesi shëndetësor, sigurimet shoqërore, politikat mjedisore dhe tatimore. Gjatë gjithë kohës ne do të përdorim teorinë dhe provat empirike për të kuptuar më mirë grupin kompleks të stimuljeve që politikat ekonomike mund të krijojnë për individët dhe bizneset. Për secilën çështje, qëllimi do të jetë zbatimi i asaj që është mësuar paraprakisht, për të analizuar çështjet aktuale të politikave dhe për të mësuar që të zhvillohen argumente analitike të arsyetuara mirë, në favor, ose kundër, politikave të veçanta.
Qëllimet e lëndës	Kjo lëndë mësimore shqyrton çështjet kryesore në politikën ekonomike. Qëllimi i lëndës mësimore është të kuptojë arsyet e ndërhyrjes së qeverisë në ekonomi, shtrirjen e asaj ndërhyrjeje dhe mënyrat në të cilat njerëzit ka të ngjarë të reagojnë duke pasur parasysh politikën ekonomike. Ne do të shqyrtojmë si politikat ekonomike që qeveria mund të ndërmarrë që kërkojnë të ardhura, ashtu edhe çështjet e qenësishme në hartimin e një sistemi tatimor për mbledhjen e të ardhurave.
Rezultatet e pritura të nxënies	Pas përfundimit të lëndës mësimore, studentët do të: - Njohin konceptet dhe modelet kryesore teorike; - Jenë në gjendje të analizojnë ndikimin e taksave dhe shpenzimeve publike në ekonomi; Jenë në gjendje të diskutojnë pyetje të ndryshme, të lidhura me ekonominë e sektorit publik, dhe të zgjidhë problemet.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	1	3	3
Ushtrime në teren			
Kollokviume	2	2	4
Detyrat e shtëpisë	1	8	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	7	14
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies	Procesi mësimor organizohet përmes ligjëratave duke aplikuar diskutim ndërveprues, punë ekipore dhe prezantimet e seminareve nga studentët, të cilat do të diskutohen gjatë orës.		
Metodat e vlerësimit	• 10% pjesëmarrje aktive gjatë në klasë; • 10% përgatitja dhe prezantimi I një seminari; • Testi 1 = 40%; • Testi 2 = 40%.		
Literatura			
Literatura bazë:	- Joseph Stiglitz, “Economics of the Public Sector“, Norton Company , 2008. - Jonathan Gruber, Public Finance and Public Policy, 2019		
Literatura shtesë:	- David N. Hyman, Public Finance: A Contemporary Application of Theory to Policy, 2020		
Plani i dizajnuar i mësimit			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e I-rë:	- Roli dhe madhësia e sektorit publik - Përcaktimi i përgjegjësisve të sektorit publik		
Java e II-të:	Matja e madhësisë së sektorit publik		
Java e III-të:	- Bazat e ekonomisë së mirëqenies - Efikasiteti i tregut		
Java e IV-të:	Dështimi i tregut		
Java e V-të:	Mallrat publike dhe mallrat private të ofruara nga shteti		
Java e VI-të:	Eksternalitetet dhe mjedisi		

Java e VII-të:	Efikasiteti dhe barazia
Java e VIII-të:	Testi 1
Java e IX-të:	Teoria e shpenzimeve publike - Prodhimi publik i mallrave dhe shërbimeve - Zgjedhja publike
Java e X-të:	Shpenzimet publike në praktikë - Korniza për analizën e politikës së shpenzimeve - Vlerësimi i shpenzimeve publike
Java e XI-të:	Mbrojtja, kërkimi dhe teknologjia
Java e XII-të:	Kujdesi shëndetësor dhe edukimi
Java e XIII-të:	Programet e mirëqenies dhe rishpërndarja e të ardhurave
Java e XIV-të:	Sigurimi shoqëror
Java e XV-të:	Testi 2

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Mashtrimi në provim; Plagjiatura; Paraqitja e gabuar ose falsifikimi i të dhënave gjatë provimit; Komunikim i paautorizuar gjatë provimeve; Lejimi me vetëdije i një studenti tjetër që të përfaqësojë punën tuaj si të vetin; Falsifikimi, ndryshimi ose keqpërdorimi i provimeve të vlerësuara, kuizeve, listave të notave ose regjistrave zyrtarë të dokumenteve; Vjedhja ose shkatërrimi i provimeve ose letrave; Paraqitja e së njëjtës punë në më shumë se një lëndë mësimore; Ndryshimi ose shkatërrimi i punës ose regjistrimeve të një studenti tjetër, Përpjekja e papërshtatshme për të ndikuar në dhënien e ndonjë krediti, note ose nderimi; Shkelja e rregullave që rregullojnë punën në grup; Mosrespektimi i sanksioneve të vendosura nën autoritetin e këtij kodi.

Zbatimi i politikave akademike dhe rregullave të sjelljes duhet të jetë në përputhje me Statutin e UP -së